



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-12012/25 datë:22.05.2025



Npi – 01/200 datë: 27.05.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 27.05.2025 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti, z.Muharrem Haziri, nga OSBE-ja, si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 29.04.2025,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)
3. Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 - 2027, (Pas diskutimit publik)
4. Diskutim dhe informim nga DKRS lidhur me mbështetjen dhe përfshirjen e komuniteteve ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes, në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit.
5. Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 29.04.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 29.04.2025.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Meqenëse kjo pikë ka me dalë në diskutim publik, kërkoj nga ju që të gjithë të bëjmë thirrje për të marrë pjesë në dëgjimet publike sa më shumë përfaqësues nga pjestarët e komuniteteve pakicë, meqenëse ky është një dokument shumë i rëndësishëm. bazë për buxhetin e ardhshëm të vitit 2026.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Po shpresoj që qeveria lokale do të organizojë dëgjime publike në fshatra edhe lagje urbane sikurse më përpara që janë organizuar. Unë kamë disa komente por do ti them me rastin e dëgjimit publik.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. KAB-i 2026-2028 është dokument shumë i rëndësishëm ku fillohet me planifikimin e projekteve për dy vitet e ardhëshme. Edhe unë i kamë disa kërkesa për disa projekte, ku realisht aty ka edhe pjestarë të komuniteteve rom e ashkali, që dmth. i prekë të gjithë nga pak. Unë edhe më parë kamë marrë pjesë në dëgjime publike por është mirë që edhe ju si përfaqësues me u angazhu pak më shumë për sa i përket Vendbanimeve ku ka më shumë pjestarë të komuniteteve si në Gjyrvokc e në Shtime. Ndoshta do të ishte mirë që me rritë pak buxhetin e ZKKK-së.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Pajtohem me ju, por po shtoj edhe diçka që të shtohet një vijë e veçantë buxhetore për festat kombëtare të komuniteteve. Mirë është me marrë pjesë sa më shumë në dëgjimet publike. Tani ne do ta nxjerrim në votim rekomandimin për Kuvendin që me qu KAB-in në diskutim publik.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -V- për vitin 2025, të mbajtur më: 27.05.2025, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për 2026-2028.**

Pika 3

Draft-Plani i punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 - 2027, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: E falënderoj Besnikun që e ka përcjellë Rekomandimin e KPK-së në Kuvend.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -V- për vitin 2025, të mbajtur më: 27.05.2025, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Draft-Planit të punës së ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027.**

Pika 4

Diskutim dhe informim nga DKRS lidhur me mbështetjen dhe përfshirjen e komuniteteve ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes, në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Drejtoreshën nuk e kemi prezent në mbledhje për ta prezantuar këtë pikë, dhe është për keqardhje, sepse jemi Komitet i përhershëm. Kjo drejtori është e rëndësishme, kështu që unë kam një thirrje për Ekzekutivin që të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, dhe të na e përcjellë informatën me E-mail.

z.Muharrem Haziri, përfaqësues nga OSBE: Përshëndetje. Nuk dua që të përzihem në punën tuaj por desha vetëm si këshillë të ju jap, që në shumicën e rasteve jo vetëm këtu por edhe në komunat tjera po del që drejtori ose në këtë rast drejtoresha është e obliguar për me raportu në Komitet. Drejtoresha i raporton Kryetarit dhe Kuvendit, ndërsa sa i përket Komitetit vetëm në rastet konkrete kur ka një çështje konkrete për trajtim vjen drejtoresha dhe e sharon.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Ky është Komitet i përhershëm dhe kishte me qenë e mirëseardhur që me u informu për punën e DKRS-së.

z.Besnik Seferi: Pajtohem me ty Kryesues, sepse drejtoresha duhet me na tregu se çka ka bërë për Komunitetin.

Pika 5

Të ndryshme


Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar në ZKKK: Përshëndetje. Ne si zyre kemi planifikuar që të bëjmë disa vizita te familjet nevojtare. Kemi identifikuar dy raste që kanë probleme me kanalizimin fekal në rrugën "Hysiqi" në Shtime, e të cilët nuk janë të lidhur në kanalizim. Unë mendoj se është mirë me dalë në teren dhe me pa se sa banorë kanë nevojë për kanalizim sa prej tyre kanë nevojë për ndriçim.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Tani unë kamë disa ditë pushim, prej 9 Qershor deri më 14 Qershor, dhe mundemi me dalë në teren. Një çështje tjetër është se ky është muaji i tretë që anëtarët e Komitetit nuk kanë marrë pagesa. Unë kamë folë me drejtorin e Financave z.Besnik Ahmetin, dhe ai më ka thënë se problemi është te Ministria. Po shpresojmë që ta gjejnë një zgjidhje, nëse jo atëherë ne bashkë edhe me komunat tjera do ta bëjmë një kërkesë në Ministri edhe në Presidencë. Tjetër Muhameti ka shprehë gatishmëri për me i ndihmu maturanat për me apliku përmes E-Kosova, për me mujtë me hy në testin e maturës.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj dhe mbledhjen e përfundoj në ora 15:00h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

